



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1004/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit N.P “Termokos” Sh.A., me numër të biznesit 70325346 dhe seli në Prishtinë, rr. “28 Nëntori”, nr. 181, Dardani, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve “A..I.” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të paraqitur ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 18/21, i lejuar më datë 19.01.2021, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 30.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, ashtu që Urdhri Përmbartimor P.nr. 18/21, i lejuar më datë 19.01.2021, nga Përmbartuesi Privat Valdrin Beka, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit N.P “Termokos” Sh.A., Kartelës së kontabilitetit me shifër 61315 të lëshuar nga kreditori, ka lejuar urdhrin për përmbartim P.nr.18/21, të datës 19.01.2021, me të cilin është urdhëruar debitori Komuna e Prishtinës, që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 10,199.28, në emër të faturave të papaguara, me kamatëvonesë prej 8% në vit duke llogaritur nga data kur kredia është bërë e arritshme për pagesë, përkatësisht nga datat sipas faturave e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të Ligjit për procedurën përmbartimore. Debitori, në prapësim ka theksuar se urdhri është i pabazuar dhe i palejuar ngase kartela e subjektit nr. 61315 mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri nuk është dokument përmbartues. Tutje, ka shtuar se urdhri është lejuar nga përmbartuesi privat mbi

bazën e nenit 29, pika 1.3 të LPP-së, mirëpo që në shkresa të lëndës nuk është bashkangjitur asnjë faturë e cila do të duhej të pranohej nga debitori, ndërsa në anën tjetër kreditori ka bashkangjitur kartelën e klientit e cila nuk paraqet titull përmbartimor. Në fund, debitori është thirrur edhe në parashkrimin e kërkesës së kreditori në mbështetje të nenit 360 të LMD-së. Gjykatës, i ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbartimor.

Në përgjigje në prapësim, kreditori theksuar se prapësimi i debitorit është i pabazuar, ngase propozimi për përmbartim është ushtruar në përputhje me nenin 38, paragrafi 1 dhe 2, të LPP-së. Ndërsa, sa i përket nenit 29 ka theksuar se debitori është dashur të mbështet në pikën 1.2 dhe 1.4 të kësaj dispozite sipas së cilave dokumente të përshtatshme për përmbartim janë ekstraktet e verifikuara nga librat afarist për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartje të mbeturinave si dhe dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike. Tutje, ka theksuar se debitorit çdo herë i është dorëzuar fatura mujore për shërbimet e ngrohjes çka vërtetohet edhe nga libra e protokollit. Në fund, ka theksuar se kërkesa e kreditori nuk është përfshi në parashkrim ngase propozimi ka të bëjë me periudhën e vitit 2018-2020. Gjykatës, i ka propozuar të refuzohet prapësimi i debitorit.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1, i LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në pikën 1.2 të po këtij nen, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Tutje, paragrafi 3 i nenit 29 të LPP-së, përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, në anën tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së, *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e cekura si më lartë, gjeti se dokumenti, përkatësisht kartela e kontabilitetit me shifër 61315, mbi bazën e së cilës është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se një dokument i tillë, nuk është i përcaktuar si dokument i besueshëm.

Me nenin 29, paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, është përcaktuar në mënyrë taksative se për cilat shërbime ekstraktet e verifikuara nga librat afariste përbëjnë dokument të besueshme. Ndërsa, duke marr parasysh faktin se në rastin konkret propozimi për përmbarrim është lejuar mbi bazën e kartelës së kontabilitetit në emër të shërbimeve të ngrohjes të ofruara nga kreditori N.P “Termokos” Sh.A., gjykata vlerëson se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarrim, e mbi bazën e të cilit përmbarruesi privat ka lejuar përmbarrimin, nuk konsiderohet dokument i besueshëm dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbarruesit duhet të anulohet dhe procedura të përfundojë në tërësi.

Meqenëse dokumenti, kartela e kontabilitetit mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbarrimor, nuk paraqet dokument të besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbarrueshmërisë, gjykata nuk lëshua fare në pretendimet e debitorit mbi parashkrimin e kërkesës, të paraqitura në prapësim.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1004/22, datë 30.03.2023

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.